



**V E N D I M**

**Nr. 6 Date 22.1. 2009**

**PER**

**MIRATIMIN I KONTRATES PER FURNIZIM ENERGJIE  
ELEKTRIKE NDERMJET SHOQERISE KESH SH.A (FURNIZUESI  
PUBLIK ME SHUMICE) DHE SHOQERISE OSSH SH.A  
(FURNIZUESI PUBLIK ME PAKICE) PER PERIUDHEN 01.07.2008  
DERI ME 31.12.2008**

Në mbështetje të neneve 9, dhe 26, pika 1, të Ligjit 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike“ i ndryshuar; te neneve 111 dhe 112/2/b, te Kodit te Procedurave Administrative, te miratuar me Ligjin nr. 8485 date 12.05.1999, pikes 4.13 gërma”A”, pika 2, të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, te miratuar me VKM nr.338, datë 19.03.2008, pikës V.1, të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.68, dt. 23.06.2008, Vendimit nr. 106, date 04.09.2008 “Per fillimin e procedurave te miratimit te kontrates se furnizimit midis KESH sh.a dhe OSSH sh.a“, Bordi i Komisionereve te Entit Rregullator te Energjise ne mbledhjen e tij te dates 22/01/2009, mbasi shqyrtoi draftin e kontrates per furnizimin me energji elektrike ndermjet KESH sh.a dhe OSSH sh.a per periudhen 01.07.2008 deri me 31.12.2008.

**Dhe Konstatoi se:**

- Me vendimin nr. 106, date 04.09.2008 Bordi i Komisionereve ka vendosur per fillimin e procedurave te miratimit te kontrates se furnizimit midis KESH sh.a dhe OSSH sh.a.
- Kontrata është lidhur nga KESH sh.a dhe OSSH sh.a, subjekte të licensuara nga ERE, përkatësisht me vendimet Nr. 9 datë 25.01.2008 dhe Nr. 11 datë 23.06.2006, të ndryshuar,
- Modeli i Tregut të Energjisë Elektrike dhe Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike përcaktojnë se kjo kontratë i nënshtrohet tregut të rregulluar.



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE**  
Bordi i Komisionereve



- 
- Në referencë të akteve të sipërcituara, ERE është autoriteti i përcaktuar për miratimin e kësaj kontratate,

Për sa më sipër evidentuar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Miratimin e kontratës „Për furnizimin me energji elektrike ndërmjet shoqërisë KESH sh.a (Furnizuesi Publik me Shumicë) dhe shoqërisë OSSH sh.a (Furnizuesit Publik me Pakicë) për periudhën 01.07.2008 deri më 31.12.2008.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftoje aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

**V E N D I M**

*Nr. 6 Date 22.1. 2009*

**PER**

**MIRATIMI I KONTRATES PER FURNIZIM ENERGJIE ELEKTRIKE  
NDERMJET SHOQERISE KESH SH.A (FURNIZUESI PUBLIK ME  
SHUMICE) DHE SHOQERISE OSSH SH.A (FURNIZUESI PUBLIK  
ME PAKICE) PER PERIUDHEN 01.07.2008 DERI ME 31.12.2008**

**Anëtarët e Bordit**

	Pro	Kundër
<b>Bujar Nepravishta</b>	_____	_____
<b>Entela Shehaj</b>	_____	_____
<b>Ardian Haçi</b>	_____	_____
<b>Abaz Aliko</b>	_____	_____